



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



KUVENDI I KOMUNËS SË KAMENICES

01 nr. _____, më _____

PROPOZIM

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c, nenit 17 dhe nenit 40, paragrafi 40.2, pika a të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr.28/2008), nenit 8 të Ligjit nr. 03/L - 049, për financat e pushtetit lokal, dhe të nenit 38, paragrafi 38.2, pika a e Statutit të Komunës së Kamenicës nr. 01-20203, dt.21/06/2023, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më _____, nxjerr këtë

RREGULLORE PËR PLOTËSIMIN NDRYSHIMIN E RREGULLORES Sh.01.Nr .5300 E DATËS 16/02/2023 PËR TAKSA, TARIFA,NGARKESA DHE GJOBA

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është krijimi i të hyrave vetanake buxhetore të Komunës, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të administratës komunale, përmirësimin, zgjerimin ose riparimin e infrastrukturës komunale.

Neni 2

Objekti i rregullimit

Në bazë të kësaj rregulloreje përcaktohen tarifat, obliguesit, procedura e pagesave, b. tarifat për taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste, pagesa e taksës komunale për Linjat Urbane dhe Autotaxi, shërbimet komunale kadastrale, shërbimet shëndetësore të nivelit parësor.

Neni 3

Lirimet nga taksa komunale

Nenit 6, i shtohet edhe paragrafi 5.

5. Çdo leje e cila inicohet dhe kërkohet nga institucionet publike, qendrore dhe lokale, e që kanë të bëjnë me interesin publik, apo është e kontraktuar nga këto organe, duke përfshi edhe çështjet humanitare, donacione dhe forma të tjera, lirohen nga pagesa e çdo takse komunale, pa marrë parasysh se nga cila drejtori lëshohet leja përkatëse.

Neni 4

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste

- Neni 13 i rregullores bazë, ndryshohet me nën paragrafët: 5.1; 5.3; dhe 10.3; dhe riformulohet:

5.1 Qarkullimi i biznesit i vitit paraprak (gjendja e përgjithshme e qarkullimit e ATK-së);
dmth fshihet nënshkrimi dhe Vulosja nga Zyrtari përgjegjës i ATK-s për gjendjen e përgjithshme.

5.3 Dokumentet e kërkuara si në pikën 5.1, duhet të dorëzohen më së largu deri më 15.04;

10.3 Paragrafi largohet në tersi.

Neni 5

Furnizimi me rrymë, gaz, avull, ajër dhe klimatizim

Ndryshon pika 1 e nenit 17 të rregullores bazë, dhe riformulohet:

1. Prodhimi i energjisë elektrike, 2000 €/muaj

Neni 6

Ndërtimtaria

- Neni 19, të rregullores bazë i shtohet paragrafi 9, dhe riformulohet:

9. punime hidraulike, instalime te ngrohjes dhe kondicionime të ajrit..... 200 €

Neni 7

Tregëtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave

- Neni 20, të rregullores bazë i fshihet paragrafi 9, dhe zëvendësohet me tekstin,

9. tregtia me pakice e karburantit e automjetit ne dyqane te specializuara
(pompat e derivateve), 300 €

Neni 20 të rregullores bazë, i ndryshohet paragrafi 18 dhe formulohet:

18. Barnatoret shëndetësore, 300 €;

-Neni 20 të rregullores bazë, i ndryshohet paragrafi 21, dhe riformulohet:

Shitore e autopjesëve dhe e autogomave, 200 €;

Neni 8

Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike

Nenit 26 të rregullores bazë, i shtohet paragrafi 9:

9. testimi teknik dhe analizat (kontrollimi teknik), 250 €;

Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ambientit, Inspektoratit dhe Emergjencave

Neni 9

Lartësia dhe pagesa e taksës komunale për Linjat Urbane dhe Autotaxi

- Nenit 35 të rregullores bazë i ndryshohet paragrafi 2; dhe 3; dhe riformulohet:

2. Çdo person fizik dhe juridik që ka të regjistruar ushtrimin e veprimtarisë Taxi shërbime, duhet të pajiset me leje pune, dhe është i liruar nga pagesa e taksës.

3. Operatorët dhe personat fizik të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, taksën e paguajnë para marrjes së rendit të udhëtimit dhe lejes së punës sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 10

Taksa mbi vendosjen e panove reklamuese

Neni 38, i rregullores bazë fshihet në tërësi dhe riformulohet:

1. Çdo shoqëri tregtare që ekspozon pano reklamuese në hapësirën publik, paguan taksë vjetore:

1.1 Panot reklamuese në hapësirat publike në zonën urbane,30,00€/m²,

1.2 Panot reklamuese në hapësirat publike në zonën jo urbane, 15,00€/m²,

1.3 Panot reklamuese elektronike-me ndriçim në zonën urbane, 40,00€/m²,

1.4 Panot reklamuese elektronike-me ndriçim në zonën jo urbane, 20,00€/m²,

Nëse kërkohet që leja të ipet më pak se një vit, atëherë pagesa duhet të bëhet për jo më pak se tre muaj.

1.5 Vendosja e ekraneve elektronike reklamuese (lëvizëse) dhe reklamimi në automjete tjera në lëvizje nëpër qytet dhe qëndrimi (vendosja) në hapësira publike:

1.5.1 Taksa ditore, 2.00€/m²,

1.5.2 Taksa mujore, 10.00 €/m²,

1.5.3 Taksa vjetore, 100.00€/m²

1.6 Nëse pano reklamuese është e vendosur në dy anët, pagesa bëhet dyfish, paguhet për dy anët.

1.7 Nëse pano reklamuese vendoset në pronë private, pala paguan 50 % të tarifave të cekura si në pikat: 1.1; 1.2; 1.3; 1.4; 1.5; dhe 1.6, të nenit 38.

2. Reklammat e vendosura që kanë të bëjnë me interesin publik dhe iniciohen nga institucionet Komunale apo shtetërore, lirohen nga pagesa.

Neni 11

Taksa për Leje hyrje/dalje në rrugët e qytetit aty ku është e ndaluar për automjetet transportuese mbi 3.5 ton

Neni 41, i rregullores bazë fshihet në tërësi dhe riformulohet:

1. Çdo automjet transportues që hyn dhe del në rrugët e qytetit aty ku është e ndaluar për automjetet transportues mbi 3.5 ton duhet të pajisen me leje (për një automjet) për hyrje/dalje:

- 1.1 taksa /tarifa ditore 10 €,
- 1.2 taksa /tarifa javore 30 €,
- 1.3 taksa /tarifa mujore 50 €,
- 1.4 taksa /tarifa vjetore 200 €

2. Janë të liruar nga pagesa e taksës:

- 2.1 automjetet zyrtare të zjarrfikësve, FSK, KFOR-it dhe policisë së Kosovës.
- 2.2 automjetet e NP, për mbeturina dhe ujësjellës kur bëjnë mbledhjen e mbeturinave, apo intervenime në rrjetin e ujësjellësit apo kanalizimit, si dhe automjetet e NPL “Dardana” ,
- 2.3 pronarët e automjeteve të cilët banojnë apo i kanë shtëpitë në rrugën ku është i ndaluar qarkullimi i automjeteve mbi 3,5 ton,
- 2.4 kur një kompani është e kontraktuar nga institucionet publike, komuna apo qeveria dhe është në interesin publik, lidhur me realizimin e ndonjë projekti, e që duhet të kalohet në këto rrugë.
- 2.5 për qytetarët që kanë shtëpitë në këtë rrugë dhe kanë nevojë për zhvillimin e punëve me transport apo furnizime të ndryshme.

Neni 12

Neni 42, i rregullores bazë fshihet në tërësi dhe riformulohet:

1. Leje për ndalje (ngarkim, shkarkim) të mallrave para lokaleve afariste, dhe në trotuar në ato vende ku nuk pengohet komunikacioni (për një automjet):

- 1.1 Për automjetet deri në 3.5 ton:

- 1.1.1 taksë /tarifë ditore, 1 €
- 1.1.2 taksë /tarifë mujore, 10 €,
- 1.1.3 taksë /tarifë vjetore, 70 €.

- 1.2 Për automjetet mbi 3.5 ton:

- 1.2.1 taksë /tarifë ditore, 2 €
- 1.2.2 taksë /tarifë mujore, 15 €,
- 1.2.3 taksë /tarifë vjetore, 100 €.

Leja e dhënë vlen për të gjitha lokalet afariste që gjinden në territorin e Komunës së Kamenicës.

SHËRBIMET KOMUNALE KADASTRALE

Ngarkesat për shërbimet komunale kadastrale

TARIFAT PËR SHËRBIMET PËR REGJISTRIMIN E TË DREJTAVE TË PRONËS SË PALUAJTSHME

Neni 13

Neni 58, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 deri në paragrafin 1.8 të rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Tarifa për regjistrimin e të drejtave në bazë të kontratës së shitblerjes..... 30€

Neni 58, paragrafi 2 fshihet nga Rregullorja bazë.

Neni 14

Neni 59 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

Tarifa për regjistrimin e të drejtave në bazë të kontratës së dhurimit..... 30€.

Neni 15

Neni 60 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

Tarifa për regjistrimin e të drejtave në bazë të kontratës mbi mbajtjen e përjetshme..... 30€.

Neni 16

Neni 61 i rregullores bazë , ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

Tarifa për regjistrimin e të drejtave në bazë të Vendimit të organit Administrativ, Gjyqësor dhe çdo dokumenti juridik që parashihet fitimi i pronësisë..... 30€.

Neni 17

Neni 62 pika 1 dhe 2 i rregullores bazë, ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:

Tarifa për regjistrimin e të drejtave në bazë të aktit juridik për krijimin e bashkëpronësisë apo pronësisë së përbashkët..... 30€.

Neni 62 pika 3 dhe 4 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

Tarifa për regjistrimin e njësisë së re kadastrale..... 10€.

Neni 18

Rregullore për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha

Neni 63 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Tarifa për regjistrimin e ndarjes nga bashkëpronësia apo pronësia e përbashkët në bazë të aktit juridik..... 30€.
2. Lirohet nga tarifa për regjistrimin e ndarjes nga bashkëpronësia kur në zonat urbane ndarja bëhet me qëllim të ndërtimit dhe krijimit të gjendjes juridike dhe kadastrale sipas planit urbanistik, para se të merret leja e ndërtimit dhe ndarja bëhet me pëlqimin e fqinjëve të asaj pjese të parcelës.

Neni 19

Neni 64 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Tarifa për regjistrimin e të drejtave në bazë të Aktvendimit mbi shqyrtimin e trashëgimisë apo Testamentit 30€.
2. Tarifa për regjistrimin e shkëputjes së bashkësisë familjare në bazë të aktit juridik..... 30€.

Neni 20

Neni 65 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

- Tarifa për regjistrimin e të drejtave në bazë të kontratës së ndërrimit-këmbimit të pronës së paluajtshme në bazë të aktit juridik..... 30€.

Neni 21

Neni 66 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Tarifa për regjistrimin e qirasë nga personi fizik apo juridik në bazë të aktit juridik..... 30€.
2. Tarifa për regjistrimin e të drejtës së shfrytëzimit - Qira mbajtjes, për pronat e privatizuara nga ish Ndërmarrjet Shoqërore, me kohëzgjatje prej nëntëdhjetë e nëntë vite (99)..... 30€.
3. Lirohet nga tarifa regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit - qira mbajtjes në emër të Qeverisë apo Komunës.

Neni 22

Tarifa për regjistrimin e Hipotekës

Neni 67 i rregullores bazë, paragrafi 1 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Tarifa për regjistrimin e hipotekës..... 30€.

Neni 23

Tarifat për modifikimin dhe fshirjen e Hipotekës

Neni 68 i rregullores bazë, pika 2 largohet nga Rregullorja bazë.

Neni 24

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e servitutit

Neni 69 pika 3 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

3. Fshirja e servitutit nga Regjistri..... 30€.

Neni 69 të rregullores bazë i shtohet pika 4 dhe formulohet si në vijim:

4. Servituti i cili regjistrohet në dy apo më shumë ZKK, tarifa përpjesëtohet në mënyrë të barabartë nga pika 1. e Rregullores bazë.

Neni 25

Tarifa për regjistrimin, modifikimin dhe fshirjen e barrëve dhe ngarkesave tjera

Neni 70 pika 3 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

3. Regjistrimi i vërejtjes sipas Ligji Nr.08/L-237 për kadastër të pronës së paluajtshme..... 10€.

Neni 70 pika 5 e rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1.5. Regjistrimi i vërejtjes në bazë të Kontratës mbi mbajtjen e përhjetshme..... 10€.

Neni 70, i rregullores bazë i shtohet pika 8 me tekstin si në vijim:

8. Lirohet nga tarifa shënimi i institucioneve publike, lokale dhe subjekteve me autorizime publike në të dhënat kadastrale.

Neni 26

Rregullore për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha

Tarifa për korrjimin e të dhënave kadastrale

Neni 71 pika 1 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Korrjimi i të dhënave kadastrale që konstatohet se janë regjistruar gabim si pasojë e dokumentacionit të dorëzuar nga palët..... 20€.

Neni 27

TARIFAT PËR SHËRBIMET TJERA

Neni 72 pika 1 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1. Certifikata online pa pagesë .

Neni 72 pika 2 fshihet nga Rregullorja bazë.

Neni 28

Tarifa për regjistrimin e të drejtave tjera

Neni 73 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

Tarifa për regjistrimin e të drejtave të cilat nuk janë përfshirë me dispozitat e kësaj rregullore..... 30€.

Neni 29

TARIFAT PËR INFORMACIONE DHE TË DHËNA NGA SISTEMI I INFORMACIONEVE KADASTRALE TË TOKAVE TË KOSOVËS NGA ZKK-të

Tarifat për informatat nga Sistemi i Informacioneve Kadastrale të Tokave të Kosovës

Neni 75 pika 1.1 e rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

- 1.1. Vërtetim që personi fizik ose juridik nuk posedon prona..... 1€ .

Neni 75 pika 1.2 fshihet nga rregullorja bazë.

Neni 75 pika 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:

- 1.3. Certifikata e pronësisë (deri në dhjetë faqe shënime të shtypura)..... 2€.

- 1.4. Certifikata e pronësisë (mbi dhjetë faqe shënime të shtypura)..... 10€.

- 1.5. Kopja e planit 2€.

Rregullore për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha

1.6. Kopje në formatin A3 me ortofoto (bardhë e zi) 5€.

Neni 75 pika 1.8 ndryshohet dhe riformulohet si në vijim:

1.8. Historiati për njësi kadastrale deri në pesë (5) njësi 50€.

Neni 75 i shtohet pika 1.9 me tekstin si në vijim :

1.9. Historiati për njësi kadastrale mbi pesë (5) njësi 70€.

Neni 30

Tarifat për bazën gjeodezike

Neni 76 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, 1.2 dhe 1.3 i rregullores bazë ndryshohen dhe riformulohet si në vijim:

1.1. Pikat trigonometrike..... 2€.

1.2. Pikat lidhëse..... 2€.

1.3. Pikat poligonale..... 2€.

Neni 76 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 dhe 1.5 fshihen nga rregullorja bazë.

Neni 76 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6 riformulohet si në vijim:

1.6. Pikat e kufijve të njësive kadastrale Y, X..... 1€.

Neni 76 paragrafi 1 i shtohet nënparagrafi 1.7 si në vijim:

1.7. Pika referente – Rendi i III-të..... 2€.

Neni 31

Tarifat për të dhënat në formën digjitale për parcela

Neni 77 pika 3 dhe 4 i rregullores bazë, ndryshohen dhe riformulohen si në vijim:

3. Parcela në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili) mbi 2 .01 ha deri 5 ha 30€.

4. Parcela në format digjitale (shpfile,dwg, gml, ili) mbi 5 ha..... 40€.

Neni 77 i shtohet pika 6, 7 dhe 8 si në vijim:

6. Ndërtesa -shtëpi banimi-(shpfile, dwg, gml, ili)..... 2€.

7. Ndërtesa – banim kolektiv - -(shpfile, dwg, gml, ili)..... 5€.
8. Pjesa e ndërtesës në format digjital (shpfile, dwg, gml, ili)..... 5€.

Neni 32

Neni 78 fshihet në tërësi nga rregullorja bazë.

Neni 33

Lirimi nga pagesa e tarifës

Neni 79 i rregullores bazë, fshihet në tërësi dhe riformulohet:

Lirimi nga pagesa e tarifës

1. Të gjithë studentët shtetas të Republikës së Kosovës, si dhe ata që vijnë nga vendet tjera me qëllime të përgatitjes së seminareve dhe punimeve të diplomës, me vërtetimin e lëshuar nga fakulteti përkatës, lirohen nga pagesa e produkteve të kërkuara deri në shumën prej njëqind euro (100 €) brenda një viti akademik.
2. Për kërkesat e studentëve të studimeve master dhe doktorantë, kur volumi i shënimeve tejkalon shumën nga paragrafi 1 i këtij neni, vendosë Drejtori Ekzekutiv i AKK-së.
3. Lirohen nga pagesa e tarifave për regjistrim (Tarifat për Shërbimet për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së paluajtshme) grupet e mëposhtme:
 - 3.1. Nënata vetushqyese;
 - 3.2. Personat me asistencë sociale, më konkretisht gratë në asistencë sociale;
 - 3.3. Personat me aftësi të kufizuara;
 - 3.4. Viktimat e dhunës në familje;
 - 3.5. Të mbijetuarat/it e dhunës seksuale gjatë luftës.
4. Lirohen nga të gjitha pagesat e tarifave grupet e mëposhtme:
 - 4.1. Familjet e dëshmorëve dhe të zhdukurve të UÇK-së.
 - 4.2. Invalidët e UÇK-së.
5. Personat nga paragrafi 3 dhe 4 duhet të prezantojnë dëshmi nga organizata ku bëjnë pjesë.
5. Lirohet nga tarifa regjistrimi i pronësisë për ndërtesat individuale të ndërtuara nga komuna apo qeveria përmes programeve për ndihmë humanitare.

6. Lirohen nga pagesa e tarifave të Shtojcës 2, Tarifat për Shërbimet për Regjistrimin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, të gjithë personat për të cilët është paraparë lirimi nga tarifatat sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 34

Bartja - transferimi i paluajtshmërive nga personi fizik te personi juridik

Regjistrimi i bartjes-transferimit të paluajtshmërive nga personi fizik te personi juridik në të cilin bartësi ka pronësi dhe anasjelltas..... 30€.

Neni 35

Para regjistrimi i të drejtës së ndërtimit, ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës

1. Para regjistrimi i të drejtës së ndërtimit sipas lejes ndërtimore si shënim në parcelë bëhet pa pagesë.
2. Para regjistrimi i ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës..... 30€.

Neni 36

Tarifat për produktet e përgatitura digjitale (jpg) sipas shkallës së zvogëlimit

Tarifat për produktet e përgatitura digjitale (jpg) sipas shkallës së zvogëlimit:

1. Printimi - A4 bardh – zi 2€.
2. Printimi - A4 kolor 3€.

Neni 37

Tarifat për Produktet - Hartat dhe Ortofotot Digjitale:

1. Ndërtesat vektor - Shtëpi banimi..... 2€.
2. Objektet banesore – kolektive..... 5€.

Neni 38

Tarifat për shërbime kadastrale dhe gjeodezike:

1. Informata për njësi kadastrale..... 2€.
2. Informata për zonë kadastrale - statistikë..... 20€.
3. Informata kadastrale për komunë – statistikë..... 30€.

Neni 39

Tarifat për hartat dhe ortofotot digjitale vetëm për Institucione Publike:

1. Harta kadastrale digjitale..... 5€.
2. Parcela – digjitale - shapefile, DWG - file 5€.

Neni 40

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Neni 87 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet:

1. Taksa mbi shërbimet shëndetësore sipas Udhëzimit Administrativ Nr. 03 / 2024 – Bashkë pagesat për shërbimet shëndetësore.

Neni 41

Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore të nivelit parësor

Neni 88 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet:

1. Lloji i shërbimit
- 1.1. Ekzaminimi mjekësor në AMF, QMF ose në QKMF, pa analiza laboratorike ose pa procedura plotësuese diagnostike me aparaturë1.00€
- 1.2. Vizita e përsëritur mjekësore që ka për qëllim shqyrtimin e rezultateve të analizave laboratorike dhe të ekzaminimeve plotësuese, të kërkuara nga mjeku i institucionit të njëjtë shëndetësor (në periudhën brenda dy javëve).....0.00€
- 1.3. Vizitat në QMF ose në QKMF e cila realizohet brenda 24 orëve prej momentit të referimit nga Punkti shëndetësor..... 0.00€
- 1.4. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF me udhëzim të Mjekut të Familjes..... 2.00€
- 1.5. Ekzaminimi specialistik në QMF/QKMF pa udhëzim të Mjekut të Familjes..... 5.00€
- 1.6. Vizita në shtëpi në thirrjet për kujdes emergjent, NËSE pas vizitës mjeku e konstaton se rasti nuk ka qenë rast urgjent-emergjent..... 6.00€
- 1.7. Me përjashtim të rasteve emergjente, qytetarët që kërkojnë shërbime në institucionet e KPSH jashtë zonës së banimit të caktuar nga institucionet përkatëse..... 5.00€
- 1.8. Ultrazëri standard i realizuar nga specialisti i radiologjisë.....2.00€
- 1.9. Radiografia2.00€

Rregullore për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha

1.10. Testet laboratorike në situatat e gjendjeve urgjente (psh leukocitet, glikemia, urina, etj)..	0,00€
1.11. Analizat laboratorike - vetëm hemogrami (SE, eritrocitet, leukocitet, hematokrit, hemoglobin, trombocite, koha e koagulimit, koha e gjakderdhjes) dhe urina (analiza e përgjithshme, gjaku me lakmues, pamja ngjyra, era, pesha specifike, pH, proteinet ne urine, ketonet, proteina, ekzaminimi mikroskopik i urines së sedimentuar).....	1.00€
1.12. Analizat biokimike (glikemia, urea, kreatinini, AST, ALT, bilirubina direkte, bilirubina totale, holesteroli, trigliceridet).....	1.00€
1.13. Analizat laboratorike – hemogrami dhe biokimike (SE, eritrocitet, leukocitet, hematocrit, hemoglobin, trombocite, koha e koagulimit, koha e gjakderdhjes) dhe urina; si dhe Analizat biokimike (glikemia, urea, kreatinini, AST, ALT, bilirubina direkte, bilirubina totale, holesteroli, trigliceridet).....	3.00€
1.14. Analizat laboratorike T3, T4,TS.....	1.00€
1.15. Analizat ASTO, Faktori rheumatoid.....	1.00€
1.16. Hemoglobina e glukogjenizuar.....	1.00€
1.17. Fraksionet e yndyrave.....	1.00€
1.18. Caktimi i sheqerit në gjak me glikometër sipas kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore.....	1.00€
1.19. Elektrolitët.....	1.00€
1.20. Audiograma.....	1.00€
1.21. Shpërlarja e veshit.....	1.00€
2.22. Përpunimi i plagëve me qepje dhe pastrimi deri në shërim të plagës (vetëm ne vizitën e parë).....	1.00€
2.23. Trajtimi ditor me injeksione dhe infuzione në institucionin shëndetësor.....	1.00€
2.24. Inhalimi ditor në institucionin shëndetësor.....	0.50€
2.25. Dhënia e raportit mjekësor, vërtetimit apo dokumentit tjetër në bazë të kërkesës së shfrytëzuesit të shërbimeve shëndetësore.....	5.00€
2.26. Ofrimi i shërbimeve shëndetësore gjatë aktiviteteve sportive, etj – për një orë.....	25.00€

Neni 42

Bashkëpagesat për shërbimet shëndetësore stomatologjike të nivelit parësor

Neni 89 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet:

1. Lloji i shërbimit

1.1 Vizita e parë stomatologjike.....	1.00 €
1.2 Vizita kontrolluese.....	0.00 €
1.3 RTG i dhëmbit.....	1.00 €
1.4 Ndalja e gjakderdhjes (urgjencë).....	0.00 €
1.5 Ndalja e e gjakderdhjes postekstraktive (urgjencë).....	0.00 €
1.6 Mbushje e përhershme me amalgamë.....	3.00 €
1.7 Mbushje e përhershme me kompozitë.....	4.00 €
1.8 Shërimi biologjik i dhëmbit me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë).....	4.00€
1.9 Shërimi i alveolitit me seanca.....	1.00 €
1.10 Amputimi vital i pulpës me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë).....	5.00 €
1.11 Ekstirpimi vital i pulpës me mbushje të përhershme të (amalgamë kompozitë)	5.00 €
1.12 Amputimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme të (amalgamë apo kompozitë).....	5.00 €
1.13 Ekstirpimi mortal i pulpës me mbushje të përhershme të (amalgamë apo kompozitë).....	5.00 €

Rregullore për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha

1.14	Terapia e kanalit të infektuar me mbushje të përhershme (amalgamë apo kompozitë).	5.00 €
1.15	Rindërtimi konservativ i dhëmbit me mbushje të mëhershme	5.00 €
1.16	Revizioni i mbushjes së kanalit të rrënjës.....	1.00 €
1.17	Fluorizimi i dhëmbëve sipas seancave.....	1.00 €
1.18	Vulosja e fisurave.....	1.00 €
1.19	Mënjanimi i depozitimeve të buta	1.00 €
1.20	Mënjanimi i depozitimeve të forta (heqja e gurëve të dhëmbëve me ultratingull)	3.00 €
1.21	Kieretazha e xhepave paradontal (një dhëmbë)	1.00 €
1.22	Nxjerrja e dhëmbit	1.00 €
1.23	Incizimi infra dhe ekstra oral	1.00 €
1.24	Heqja e kurorës me anë të prerjes	1.00 €
1.25	Drenazha e dhëmbit	1.00€
1.26	Riparimi i protezës (ngjitja)	1.00 €
1.27	Heqja e penjve	0.00€

Neni 43

Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruara nga bashkë pagesat

Neni 91 i rregullores bazë, ndryshohet dhe riformulohet:

1. *Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruara nga bashkë pagesat sipas Ligjit për shëndetësi janë:*

1.1. Personat që kanë të ardhura më të ulëta se niveli zyrtar i ndjeshmërisë sociale i përcaktuar nga Qeveria, në kategoritë e individëve të regjistruar si të ndjeshëm në aspektin social ose si të varfër, në bazë të aktit nënligjor të nxjerrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria përkatëse për Mirëqenie Sociale.

1.2. Viktima të trafikimit gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar, në pajtim me ligjin;

1.3. Banorët e përhershëm të vendbanimeve joformale në Republikën e Kosovës që nuk janë të regjistruar ose të cilët janë në proces të regjistrimit deri në përfundim të procesit të regjistrimit, ose deri një (1) vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, çfarëdo realizohet më parë;

1.4. Personat e ri-atdhesuar bazuar në marrëveshjet bilaterale të Republikës së Kosovës me shtetet e tjera, në vitin e parë pas ri-atdhesimit;

1.5. Të burgosurit të cilët janë në mbajtje të dënimit;

1.6. personat të ç'vendosur me dhunë jashtë shtëpive të tyre si viktima të dhunës familjare, gjatë vitit të parë pas regjistrimit zyrtar, në pajtim me ligjin.

1.7. Dhuruesit e gjakut që posedojnë dëshminë e lëshuar nga QKKTGJ (Qendra Kombëtare e Kosovës për Transfuzionin e Gjakut) se kanë dhënë gjak së paku pesë (5) herë në dy (2) vitet e fundit. Dhuruesit me numër më të vogël të dhurimit të gjakut lirohen për 12 muaj të ardhshëm nga data e dhurimit të fundit.

2. *Kategoritë e qytetarëve dhe banorëve të liruara nga bashkë pagesat sipas ligjeve tjera përkatëse në fuqi, janë:*

2.1 Pensionistët e moshës dhe ata kontributdhënës;

2.2 Pensionistët e kompanisë “Trepça”;

2.3 Pensionistët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës;

- 2.4 Ish të burgosurit politik si dhe bashkëshortja dhe fëmijët e tyre;
- 2.5 Viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës;
- 2.6 Personat me aftësi të kufizuar;
- 2.7 Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe anëtarët e familjes së ngushtë;
- 2.8 Anëtarët e familjes së ngushtë të dëshmorëve;
- 2.9 Anëtarët e familjes së ngushtë të zhdukurve të UÇK-ës dhe të zhdukurve civil;
- 2.10 Pjesëtarët e UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë;
- 2.11 Viktimat civile të luftës dhe anëtarët e familjes së ngushtë;
- 2.12 Invalidi i UÇK-së dhe anëtarët e familjes së ngushtë;
- 2.13 Familjet e varfra nën asistencë sociale - të gjithë anëtarët e familjes;
- 2.14 Individët të cilët janë duke jetuar në institucione shtetërore -fëmijët nën kujdes dhe nën kujdestari, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara të strehuar në shtëpitë për persona të moshuar, si dhe në shtëpitë për integrim në komunitet;

3. *Kategoritë e liruara nga bashkë pagesa përfshihen edhe këto kategori të popullatës:*

3.1. Të gjitha llojet e imunizimit të obliguara me ligj, mamografia, PAPA –testi dhe testi i tuberkulinës;

3.2. Fëmijët deri në moshën 18 vjeçare , nxënësit , studentët deri në moshën 26 vjeçare;

3.3. Shtatzënat dhe shërbimet e lidhura me planifikimin e familjes (përveç ndërprerjes së dhunshme të shtatzënisë pa shkaqe socio-medicinale);

3.4. Personat e moshës mbi 65 vjeçare;

4. Pacientët me sëmundje të rënda kronike dhe sëmundje malinje si :

4.1. Diabetes Mellitus tip 1 (E10);
Diabetes Mellitus tip 2 insulin vartës (E11);

4.2. – C97);

4.3. Cirroza hepatike (K70 – K76);

4.4. LES M32, M05, M06, M07, M34, M45;

4.5. Sarkoidoza (D86);

4.6. SPOK (J43, J44, J45, J46, J47, J96);

4.7. Demenca dhe psikozat kronike, retardimi i rëndë (F00 – F03; F20; F22; F25; F31; F32; F33; F34; F70; F71; F72; F73; F78; F79);

4.8. Sëmundjet e Sistemit Nervor (Parkinsonizmi, Skleroza multiple, Epilepsia , Miastenia Gravis, Distrofia muskulare, paraliza infantile spastike, hemiplegjia, paraplegjia, tetraplegjia) (G20, G35, G40, G70, G71, G8-G83);

4.9. Personat e verbër dhe të shurdhër (H54; H90; H91);

5. Të gjithë personat me paaftësi si dhe sëmundjet e tjera të cilat i përcakton Ministria e

Rregullore për Plotësim Ndryshimin e Rregullores për Taksa, Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoba

Shëndetësisë.

6. Bashkë pagesat për shtetasit e huaj

Bashkë pagesat për shtetasit e huaj për kujdes shëndetësor bëhen në kushte të njëjta si edhe qytetarët e tjerë të Republikës së Kosovës.

Neni 44

Çmimorja në Qendrën për Punë Sociale-QPS

Neni 92, nënparagrafi 1,2 i rregullores bazë ndryshohet dhe riformulohet:

1. Lloji i shërbimit:

1.2. Vërtetim për posedim të zotësisë së veprimi për punësim..... 0.00 €

Neni 45

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Liridon KASTRATI